

Këshilla për të ushqyerin, blerjen e gjedhit të racës dhe planifikimi i stallave për: lopët e qumështit, vicat, remontin

Austria Praemix shpk ofron këshillim nëpërmjet ekipit të saj:

Z. Olger Nanagjoka

Dr. Hans Spornbauer

DI. Bianca Duro

DI. Peter Salmutter

Ing .Franz Riegler



Në mbarështimin e gjedhit, ushqimi i prodhuar nga vetë ferma përbën bazën për menaxhimin e suksesshëm të tufës. Ushqimet voluminoze me cilësi të lartë janë kusht për kafshë të shëndetshme dhe rendimente të larta. Cilësia e ushqimit nuk është konstante, prandaj analizimi i tij është shume i rëndësishem. Përpilimi i racioneve ushqimore duhet të bëhet vërtëm mbi bazën e këtyre rezultateve. Për të gjitha kategoritë, nga vicat deri tek lopët e qumështit, duhet të synohet një përshtatje e racioneve me të gjithë përbërësit, makro dhe mikro-elementet më të rëndësishem, sipas nevojave të organizmit.

Këshillat e specialistëve të Austria Praemix shpk vijnë në fermën tuaj dhe ju ndihmojnë në përpilimin optimal të racioneve ushqimore.

1. Të ushqyerit e remontit

Situata juaj në fermë:

- Disa ferma përballen me humbjen e viçave
- Kostot veterinare për vicat dhe mëshqerrat rriten
- Moshë në lindjen e parë të mëshqerrave rezulton e lartë (mbi 30 muaj)

Oferta jonë:

1. Ne vlerësojmë gjendjen të vicat dhe mëshqerrat tuaja në fermë
2. Ne përpilojmë racionin ushqimor dhe planin e pirjes për vicat tuaj
3. Ne formulojmë racionin e koncentratit për mëshqerrat deri në pjelljen e parë
4. Ju merrni një udhëzues të shkruar për tufën tuaj

Përfitimi juaj:

- ✓ Ulja e humbjeve të vicave në masën nën 5% në bashkëpunim me veterinerin tuaj
- ✓ Moshë e vicave në moshën 6-8 javë
- ✓ Arritja e pjelljes së parë në moshën 26-28 muaj
- ✓ Ulja e kostove veterinare për remontin

2. Të ushqyerit e lopëve të qumështit

Situata juaj në fermë:

- Ju dëshironi të përmirësoni racionin për lopët tuaja të qumështit
- Ju keni patur një konsumim shumë të lartë koncentratit dhe rendiment qumështi jo të kënaqshëm
- Përballeni në fermë me probleme të metabolizmit tek lopët e qumështit
- Dëshironi të përmirësoni rendimentin e pjellorisë tek lopët tuaja të qumështit

Oferta jonë:

1. Vlerësim i kondicionit në individë të vecantë në stallë
2. Vlerësimi i racionit direkt në stallë
3. Vlerësimi i jashtëqitjes dhe urinës për të identifikua problemet e metabolizmit
4. Llogaritja e racionit me programin Schaumann

5. Këshillim individual i të ushqyerit.
6. Mbikqyrje e vazhdueshme për kontroll të suksesit në fermë

Përfitimi juaj:

- ✓ Përmirësimi i shëndetit të tufës (metabolizmi, pjelloria, thundrrat) - baza për rendimente të larta
- ✓ Përmirësimi i rendimentit të qumështit duke përshtatur furnizimin me makro dhe mikroelementë
- ✓ Menaxhimi i të ushqyerit i përshtatur sipas kërkesave të tufës

3. Kontrolli i ushqimeve në fermë

Situata juaj:

- Ju nevojiten të dhëna të sakta të ushqimeve që përdorni në fermë
- Ju nuk jeni të kënaqur me cilësinë e silazhit tuaj
- Ju dëshironi të jeni të sigurtë për cilësinë e produkteve të blera që përdorni në racion

Oferta jonë:

1. Marrje e provës së ushqimit në fermë
2. Plotësimi i formularit me kërkesën për analizat
3. Ndihmë në përzgjedhjen e elementëve përbërës për kontroll
4. Paketimi dhe dërgimi i provave në laboratorin e produkteve ushqimore Rosenau të LLWK në Austri
5. Interpretimi i rezultateve të analizave
6. Në rast nevojë këshillim i mëtejshëm i detajuar
7. Marrja përsipër në masën 20% të kostove për realizimin e analizave, paketimi, dërgimi në Austri, 80% të kostove të analizave duhet të kalohen nga klienti

Përfitimi juaj:

- ✓ Përpilim i saktë i racionit ushqimor mbi bazën e analizave të lëndës së parë
- ✓ Baza të shëndetëshme për mënjanimin e problemeve të të ushqyerit dhe për shëndetin e kafshëve
- ✓ Konkluzione të sakta në lidhje me plehun dhe orientimin për kultivimin /planifikimin e foragjereve